

VENDIM
Nr. 171, datë 24.3.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, që i bashkëlidhet vendimit nr. 752, datë 19.12.2018, të Këshillit Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Bordi i Apelit përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 janë punonjës të DPPI-së dhe 3 anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së, të cilët plotësojnë kushtet për ekspertë të PI-së.”;

b) Në fjalinë e parë, të pikës 3, numri “2” zëvendësohet me “3”;

c) Në pikën 4, numri “... dy ...” zëvendësohet “... tre ...”.

2. Pika 6, e nenit 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Kryetari i Bordit të Apelit cakton një anëtar të Bordit të Apelit, që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, të përgatitë vendimin e arsyetuar, një kopje e të cilit i dorëzohet sekretarit teknik nëpërmjet zyrës së protokollit për t’ia bashkëlidhur dosjes së çështjes.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku